



Datë: 08.05.2025
Numër Protokolli: 3294/2025

A.nr.417/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.417/2025, të datës 04.03.2025, të parashtruar nga ankuesja G.L, kundër organit të punësimit: Autoritetit të Konkurrencës së Republikës së Kosovës, në çështjen juridike “*vlerësim i rezultateve të punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 08.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. ANULOHEN Vlerësimet e rezultateve të punës për vitin 2024, për ankuesen G.L.

II. OBLIGOHET Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit në Autoritetin e Konkurrencës së Republikës së Kosovës, në cilësinë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë që në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi, t’i ndërmarrë të gjitha veprimet me qëllim që ankueses t’i bëhet **rivlerësimi** i rezultateve të punës për vitin 2024, për periudhën nga data 25.06.2024 deri më 31.07.2024.

III. OBLIGOHET U.D Udhëheqësi i Divizionit për Marrëveshjet e Ndaluara, në Autoritetin e Konkurrencës së Republikës së Kosovës, në cilësinë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë që në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi, t’i ndërmarrë të gjitha veprimet me qëllim që ankueses t’i bëhet **rivlerësimi** i rezultateve të punës për vitin 2024, për periudhën nga data 01.08.2024 deri më 31.12.2024.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë Vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, G.L (*tutje referuar vetëm: Ankuesja*), më datë 04.03.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të regjistruar nën shenjë A.nr.497/2025, kundër formularëve të vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2024.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Autoriteti i Konkurrencës së Republikës së Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: AKRK*), ndërsa ky i fundit më datë 21.03.2025, ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë.

Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së krytares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 2570/2025 të datës 15.04.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesja edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova (*në tekstin e mëtejme referuar Kolegji i Këshillit*) : Ankesën me numër protokoli 1439/2025, të datës 04.03.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Dokument identifikimi i ankuses; Kërkesën e datës 09.01.2025; E-mailin e datës 06.01.2025; Vendimin me numër protokoli 07/25-06/B të datës 06.01.2025; Vendimin me numër protokoli 393/24-06/B të datës 24.06.2024; Kërkesën e datës 15.08.2024; Formularin e vlerësimit të rezultateve të punës të datës 27.02.2025; Formularët e vlerësimit të rezultateve të punës të datës 26.02.2025; Fotografi nga kompjuteri; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë të datës 21.03.2025; Akt emërimit me numër protokoli 664/23-07/B, të datës 29.12.2023; Përshkrimin e detyrave të punës të datës 04.01.2024; Vërejtjen me shkrim të datës 26.09.2024; Akt emërimit me numër protokoli 665/233-07/B, të datës 29.12.2023; Vendimin me numër protokoli 78/25-06/B, të datës 11.02.2025; Akt emërimit me numër protokoli 106/13 të datës 27.05.2013; Vendimin me numër protokoli 219/23-06/B të datës 16.05.2023; Vendimin me numër protokoli 101/24-06/B të datës 14.02.2024.

Kolegji i Këshillit, për vendosjen e kësaj çështje pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të bashkëngjitura nga ankuesja dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ekziston baza ligjore për të vendosur, që lënda e ankuses të ***kthehet në rivlerësim, sepse:***

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesja, është e punësuar në Autoritetin e Konkurrencës së Republikës së Kosovës, përkatësisht sipas Akt emërimit numër protokoli 664/23-07/B, të datës 29.12.2023, në pozitën e punës “*Inspektore Hetuese e Konkurrencës*”.

Si rrjedhojë, ankuses për vitin 2024, i janë realizuar tri vlerësime të rezultateve të punës, gjegjësisht sipas Formularit të Vlerësimit të Rezultateve të Punës, të datës 26.02.2025, të z.Sh.E- Inspektor për

hetimet e shkeljeve të konkurrencës në treg, i cili sipas Vendimit me numër protokolli 219/23-06/B të datës 16.05.2023, të U.D Drejtorit të Përgjithshëm, ishte emëruar U.D Drejtor i Departamentit të Mbikëqyrjes të Tregut, pozitë të cilin e kishte ushtruar deri në nxjerrjen e Vendimit me numër protokolli 101/24-06/B, të datës 14.02.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm, përmes të cilit ishte shfuqizuar vendimi paraprak për emërimin e tij në këtë pozitë, ankuesen në cilësinë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, për periudhën kohore nga data 01.01.2024 deri më 14.02.2024, e ka vlerësuar me nivelin: ***tejkalon pritshmëritë.***

Tutje, për periudhën nga data 15.02.2024 deri më 31.07.2024, z. S.B-Drejtori i Përgjithshëm i AKRK-së, në cilësinë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankueses, të njëjtën përmes Formularit të Vlerësimit të Rezultateve të Punës, të datës 26.02.2025, e ka vlerësuar me nivelin: ***ka nevojë për përmirësim.***

Ndërsa, sipas Formularit për Vlerësimin e Rezultateve të Punës, të datës 27.02.2025, z. A.R- Inspektor Hetues i Konkurrencës, i cili sipas Vendimit Nr.37/24 të datës 30.07.2024, është emëruar Ushtrues Detyre i Udhëheqësit të Divizionit të Marrëveshjeve të Ndaluar, ankuesen në cilësinë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të saj, për periudhën e mbetur të vitit 2024, e ka vlerësuar me nivelin: ***ka nevojë për përmirësim.***

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Drejtori i Përgjithshëm për periudhën e njëjte kohore e ka vlerësuar të njëjtën dy here, përkatësisht më datë 24.06.2024 kur i është konfirmuar marrëdhënia e punës, duke theksuar ndër të tjera se vlerësimi i dytë për periudhën e njëjtë është tendencioz, ndërsa sa i përket vlerësimit të z. A.R, ankuesja thekson se i njëjti nuk mund ta vlerësoj sepse e njëjta më datë 15.08.2024, ka parashtruar kërkesë për ndërrimin e divizionit, dhe si për rrjedhojë ankuesja kërkon aprovimin e ankesës, anulimin e Formularit të Vlerësimit të Rezultateve të Punës të datës 25.02.2025, të Sekretariatit të AKRK-së, me obligimin që Njësia e Burimeve Njerëzore ta largoj nga dosja personale vlerësimin e ankueses.

Kolegji i Këshillit, në kuptim të shqyrtimeve të pretendimit ankimor të ankueses, lidhur me vlerësimin e dyfishtë për periudhën e njëjtë kohore, dhe duke qenë se e njëjta ka themeluar marrëdhënien e punës përmes Akt emërimit me numër protokolli 664/23-07/B, të datës 29.12.2023, nga rezulton se e njëjta ka qenë në periudhën provuese prej 6 (gjashtë) muajsh, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 51, ku përcaktohet se: *1. Nëpunësja/i civil që emërohet për herë të parë në pozitë të kategorisë profesionale apo të specialistes/it në shërbimin civil, apo që merr mandatin sipas nenit 46 dhe 49 të këtij ligji, i nënshtrohet periudhës provuese që zgjatë gjashtë (6) muaj nga data e nënshkrimit të aktit të emërimit nga të dy palët. 2. Gjatë periudhës provuese, nëpunësja/i kryen trajnimet e detyrueshme dhe kryen detyrat nën mbikëqyrjen e mbikëqyrëses/it të drejtpërdrejtë. 3. Nëpunësja/i civil, gjatë periudhës provuese nuk mund të transferohet dhe nuk mund të marrë pjesë në komisione që themelohen nga institucionet për të cilat kërkohet përvojë profesionale. 4. Para përfundimit të periudhës provuese, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë bën vlerësimin e rezultateve të punës për këtë periudhë. 5. Në fund të periudhës provuese, mbështetur në vlerësimin e rezultateve të punës të nëpunës/it, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë vendos: 5.1. konfirmimin e marrëdhënies së punës të nëpunës/it në shërbimin civil;*

5.2. zgjatjen e periudhës provuese një herë të vetme, deri në gjashtë (6) muaj të tjerë, nëse për arsye të justifikuara ka qenë i pamundur vlerësimi i plotë i nëpunëses/it; 5.3. mos konfirmimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil të nëpunëses/it dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil.; dhe duke qenë se Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit i AKRK-së, përmes Vendimit me numër protokolli 393/24-06/B të datës 24.06.2024, pas periudhës provuese i ankueses i ka konfirmuar marrëdhënien e punës, me arsyetimin se duke u bazuar në vlerësimin e suksesshëm të përgatitjes teorike dhe praktike gjatë kryerjes së detyrave të punës për pozitën e emëruar, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesja deri në datën e nxjerrës së Vendimit të sapo theksuar është vlerësuar, ndaj e njëjta nuk mund të vlerësohet për periudhën e njëjtë kohore, siç është vepruar në rastin konkret, kur është vlerësuar përmes Formularit të Vlerësimit të Rezultateve të Punës, për periudhën nga data 01.01.2024 deri më 14.02.2024 dhe Formularit të Vlerësimit të Rezultateve të Punës, për periudhën nga data 15.02.2024 deri më 31.07.2024, mirëpo në kuptim të paragrafit 9 të Nenit 52 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: 9. “Përjashtimisht, në rastin e ndërrimit të mbikëqyrëses/it përpara përfundimit të vlerësimit vjetor, secila/i mbikëqyrëse/ës vlerëson nëpunësen/in vetëm për periudhën përkatëse”, e njëjta duhej të vlerësohej vetëm pas datës së konfirmimit të marrëdhënies së punës, apo thënë më konkretisht nga data 25.06.2024 deri më 31.07.2024, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesja duhet të vlerësohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit i AKRK-së, i cili ka qenë në cilësinë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankueses, deri në nxjerrjen e Vendimit me numër protokolli 486/24-26/B të datës 30.07.2024.

Tutje, nga Formulari për Vlerësimin e Rezultateve të Punës, të datës 27.02.2025, të realizuar nga Ushtrues Detyre i Udhëheqësit të Divizionit të Marrëveshjeve të Ndaluara, i cili në cilësinë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankueses, rezulton se të njëjtën e ka vlerësuar me nivelin: **ka nevojë për përmirësim**, e që sipas nenit 9 paragrafit 3 nën paragrafit 3.4 të Rregullores Nr.26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë, për nivelin “Ka nevojë për përmirësim”, shprehimisht theksohet se: *është vlerësim që tregon se nëpunësi civil nuk ka arritur të përmbushë në mënyrë të plotë pritshmërinë dhe kërkesat për rolin e tij. Ekzistojnë fusha ku kërkohet përmirësim i dukshëm për të arritur nivelin e pritshëm të performancës*; mirëpo Kolegji i Këshillit, konstaton se ky Formular, përmban mangësi të theksuara, dhe është i përfshirë me shkelje të ligjit material, përkatësisht të dispozitave të Nenit 52 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores Nr.26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë, e cila përcakton rregullat, metodologjinë dhe procedurën për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësit civil, ngase nga shkresat e lëndës Kolegji i Këshillit, të bashkangjitura nga organi i punësimit fillimisht Kolegji nuk ka gjetur asnjë dëshmi mbi përcaktimin e objektivave individuale siç përcaktohet me nenin 4 dhe 5 të këtij Ligji dhe nenin 4 të kësaj Rregulloreje, ku shprehimisht theksohet se: 1. Përcaktimi i objektivave individuale të nëpunësit civil bëhet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me nëpunësin, së bashku me planin individual të punës për arritjen e këtyre objektivave. Gjatë përcaktimit të objektivave, NjMBNj siguron përfshirjen e trajnimeve të nevojshme për nëpunësin civil në planin individual të tij. 2. Plani individual i punës sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund të rishikohet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesi i njësisë së burimeve njerëzore, në bashkëpunim me nëpunësin civil. 3. Objektivat e punës duhet të jenë konkrete, të matshme, të arritshme, relevante dhe të përcaktuara në kohë....., ndërsa po ashtu, Kolegji i Këshillit, konstaton se është vepruar në kundërshtim edhe me nenin 52 paragrafin 11 të Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku theksohet: 11. Mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë

gjatë procesit të vlerësimit është e/i obliguar të vlerësojë nëpunësen/in në mënyrë objektive dhe të argumentojë vlerësimin;, sepse në asnjë prej rubrikave të këtij formulari të vlerësimit, nuk rezulton të jenë dhënë komente nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë apo arsyetim se pse është vlerësuar me nivelet përkatëse ankuesja, gjegjësisht nuk ka shpjeguar as edhe një koment të vetëm dhe ta jap mendimin lidhur me përmbushjen apo jo të njërës prej objektivave dhe detyrave të punës si dhe ndër të tjera në kuptim të nenit 52 paragrafit 12 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: 2. *Në fund të periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore zhvillojnë takim me nëpunësen/in për vlerësimin e rezultateve të punës. Pas takimit, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë aprovon formularin e vlerësimit që e nënshkruajnë të gjitha palët.*; Kolegji i Këshillit, konstaton se është vepruar në kundërshtim me këtë përcaktim ligjor, ngase nga shkresat e bashkangjitura të lëndës nuk rezulton asnjë dëshmi se ankuesja është ftuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë apo përfaqësuesi/ja i/e Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në organit përkatës të punësimit, dhe se po ashtu ky Formular i Vlerësimi të Rezultateve të Punës i realizuar nga U.D i Udhëheqësit të Divizionit të Marrëveshjeve të Ndaluar nuk është nënshkruar nga të gjitha palët, siç edhe nuk është specifikuar as periudha e vlerësimit të ankueses.

Andaj, bazuar në konstatimet e më sipërme dhe duke qenë se ankueses më datë 24.06.2024, i është konfirmuar marrëdhënia e punës pas vlerësimit të suksesshëm dhe atë sipas Vendimit me numër protokolli 393/24-06/B, ndërsa duke qenë se Formulari i Vlerësimit të Rezultateve të Punës, i datës 27.02.2025, është i përfshirë me shkelje të dispozitave të ligjit material siç janë pasqyruar më sipër, si për rrjedhojë, Kolegji i Këshillit, vendosi të anuloj që tri Formularët e Vlerësimit të Rezultateve të Punës për vitin 2024, të ankueses, me obligimin që Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të AKRK-së, në cilësinë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të bëj rivlerësimin e rezultateve të punës për ankuesen për periudhën nga data 25.06.2024 deri më datë 31.07.2024, ndërsa U.D i Udhëheqësit të Divizionit të Marrëveshjeve të Ndaluar, është i obliguar që ankueses ti bëjë rivlerësimin e rezultateve të punës për periudhën nga data 01.08.2024 deri më datë 31.12.2024, kur i njëjti ka qenë në cilësinë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë e saj, duke vepruar në pajtim me nenin 52 të Ligjit Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë.

Bazuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.417/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses, G.L;
- Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të AKRK- së;
- U.D Udhëheqësit të Divizionit të Marrëveshjeve të Ndaluara të AKRK- së;
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në AKRK; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.